

**ABDULLA BALLHYSA
NEIM ZHURI**

**“MËSUESET E FSHATIT”
– LEXIM NDRYSHE I NJË PEIZAZHI MIGJENIAN**

Në përpjekjen për të lexuar ndryshe një nga poezitë e spikatura të Kadaresë, i jemi referuar faktit se letërsia, me lirinë ndaj çdo detyrimi referencial realizon superioritetin e gjuhës, mbi çdo lloj aktiviteti tjetër dhe trajtohet si e veçuar prej të gjitha mënyrave të tjera të përdorimit të gjuhës, duke qenë se zbulon para nesh mënyrën e vërtetë të përdorimit të saj.

Në dallim nga stilisticienët e Pragës, Leo Spitzeri, zhvilloi një metodë të analizës stilistike që përqendrohet në tekstin individual, që nuk e përfaqëson stilin me terma thjesht gjuhësorë, por e lidh studimin me interpretimin e përmbajtjes letrare. Spitzeri orienton se një analizë e mirëfilltë stilistike mund të fillojë nga ndonjë detaj i tekstit, që mund të evidentohet si devijim në lidhje me mënyrën e stabilizuar të të shkruarit. Kjo i jep dorë studiuesit për ta lidhur thelbin e çështjes me përshtypjen e ndjenjës së tij për veprën në tërësi. E thënë ndryshe, kjo lloj analize përfshin përshkrimin e saktë jo vetëm të gjuhës së tekstit, por, njëherazi, edhe të përmbajtjes së tij.

Nisur nga kjo bazë teorike na lind e drejta që të kryejmë disa operacione semantike dhe leksikore, të cilat besojmë se do na mundësojnë të nxjerrim në pah disa vlera të fshehura të veprës. Nuk bëhet fjalë për tërësinë e veprës së Kadaresë, por për një nga krijimet më të spikatura të tij, poezinë “Mësueset e fshatit”.

A është rastësi që poezia nis me leksemën “udhëkryq” (Në udhëkryqe ndanë xhadeve)? Imazhi që të krijon poezia e kontekstualizuar në procesin e socializmit është larg konformizmit sa i përket stereotipit “mësuesi komisar i dritës”, “mësuesi militant”, “mësuesi hero”. Stereotipa të tillë a ishin tregues i një komunikimi univok, të një kulture që çonte në rrugën e bllokimit, rrjedhë socio-kulturore që reduktohej me një mesazh unik?

Antikonformizmi Kadarean të çon larg këtij stereotipi, për rrjedhojë imazhi është krejt tjetër. Ato, *të urtat gjer në dhembje*, janë në udhëkryq.

Ky udhëkryq materializohet në poezi përmes dhembjes, një nga fjalët çelës të poezisë (dy janë ato: “dhembje” dhe “madhështi”).

Nëse e kuptojmë imazhin si një paraqitje elementesh të pranishëm në shpirtin e shkrimtarit, ai na shpaloset si një gjuhë, një gjuhë e dytë paralele me gjuhën që uni flet.

A na shfaqen ato të nënshtruara dhe kokulura siç e donte ajo kohë, a meritojnë ato të konsiderohen përmendore të madhësisë dhe lirisë së ëndërruar?!

Studiuesit kanë konstatuar se Kadare i viteve '60, besonte në forcën transformuese të artit, në ndryshimin revolucionar të shoqërisë. Kjo ishte arsyeja që “duke folur për gjuhën të veprave të Kadaresë, si strehë dhe projektion krijues të lirisë individuale kam pasur bindjen se tëhuajëzimi i Kadaresë nga socrealizmi ka qenë mospajtimi stilistik dhe estetik... që u mishërua me kundërvënien e gjuhës, modelit dhe stilit letrar, e cila sigurisht projektohet në krejt sistemin e ndjeshmërisë dhe shijes për të bukurën”¹.

Kadare bëhet kështu bartës i një stili të ri metaforik i cili çon drejt një bërthame të re semantike të ligjëritimit për të krijuar njësi të reja domethënëse, brenda atij sfondi vlerash të shoqërisë. Ajo çka e bën të veçantë fenomenin Kadare është “guximi dhe imagjinata e jashtëzakonshme në përdorimin e simbolikës letrare ... marrëdhënia midis vetëdijes dhe instinktit krijues të shkrimtarit si një fenomen teorik, ... që ka rëndësi të veçantë në interpretimin e disa veprave të periudhës së Realizmit socialist”².

Tek “mësueset e fshatit” Kadare nuk rreket të konfirmojë, si në shumë krijime të asaj kohe, prirjen për të mitizuar “njeriun e ri”, në projektin monstruoz të atij njeriu të modeluar, “që me duart e veta, madje duke kënduar e vallëzuar, do të mbyste lirinë”³.

Tek “mësueset...” e Kadaresë është vështirë të kërkosh “heroinën” apo “personazhin pozitiv” sajuar me shtrëngesë, që u kthye në qëllim themelor të letërsisë së Realizmit socialist, aq sa “edhe kur mungonte ose nuk gjendej nga kritika, shpikëj si “hero pozitiv” edhe diçka jonjerëzore, mjafton të plotësohej kushti i mitologjisë së Realizmit socialist, një qytet, një kantier apo edhe “një kështjellë” që përbën heroin pozitiv”⁴. Në këtë

¹ A. Tufa, *Studime Albanologjike*, 2010/2, f. 191.

² F. Dado, *Letërsi e painterpretuar*, viti 2006, f. 223.

³ I. Kadare, *E vërteta që del nga qilarët*, “Vepra”, vëll. 20, Tiranë, 2009, f. 443.

⁴ Sh. Sinani, *Dosie K*, Tiranë, 2011, f. 48.

poezi, pa ngarkesë të tepruar metaforike, ato na vijnë të thjeshta dhe njerëzore, madje të përlura dhe të pambrojtura, aq sa natyrshëm, në një lexim të sotëm, heq pa ngurruar një paralele me tablotë migjeniane.

Qysh në strofën hyrëse, nëse zëvendëson vetëm një leksemë, që në fakt edhe pse nuk është, nënkuptohet si e tillë, përftohet kjo strofë “e re”:

Në udhëkryqe, ndanë xhadeve
Ditët e shtuna dalin shpesh.
Dhe zgjasin dorën për lëmoshë
Herë dy nga dy, herë veç e veç.

Ndoshta jo në përmasën e lipsave migjenianë “që shtrijnë duart e mpita”, por gjithsesi lipin, lipin dinjitet, liri, siguri për ëndrrat e frikura. Lexuesi i sotëm duhet të ketë erudicionin e duhur për të nënkuptuar se ky aluzion i përcaktuar përbën tërthoritetin e ligjërimit.

Kadare na sqaron në një intervistë se “ulja e kokës” ishte programuar si pjesë e nënshtrimit dhe se vajzat shqiptare, të cilat më shumë vështirësi përpiqeshin të ruanin dinjitetin, pjesë e të cilit ishin, ndër të tjera edhe hijeshia edhe eleganca, u duhej të përballeshin me cinizmin e burokratëve kokëtrashë për të cilët, këto cilësi quheshin sfiduese. Stilema “të urtat gjer në dhembje”, nuk ka modalitetin e urtësisë, por të heshtjes. Dhe heshtja, përveçse simbol i censurimit, është njëkohësisht mënyrë mbijetese. Në marrëdhënie me leksemën “madhështi” kuptimi mbishtresohet, si një mbishtresim kuptimor antonimik.

Leksema “pretendim” e vënë në gojën e burokratëve është një lloj kufiri që i vihet lirisë, “boll, deri këtu”, “çdo donin më tepër ato”?

“Si shumë pretendime kanë
Mor shoku Jani, këto vajza...”

Pretendim sipas fjalorit të sotëm të gjuhës shqipe do të thotë: - kërkesë e tepruar të cilën dikush duhet ta ketë si privilegj.

Por a mund të quhet “pretendim” kërkesa e këtyre vajzave, që me duar të shtrira njëlloj si lipsat e Migjenit, veçse (objekti i lypjes ndryshon), nuk kërkojnë lëmoshë, por pak qytet, pak jetë ndryshe, që të shpëtonin nga mykja e monotonia e një jetë dhe fati të paracaktuar. Lexuesi i sotëm, vetëm në rastin që do të mund të kthehet në një lexues bashkëpunëtor, mund të kuptojë se fati i paracaktuar i këtyre vajzave nuk mund të refuzohej, sepse pasojat ishin fatale, “...gjithë biografia merrte një njollë që nuk shlyhej tërë jetën” (intervista e Kadaresë).

Duke e parë (për efekt analize) tekstin si gërshetim të disa niveleve, nuk mund të lëmë jashtë vëmendjes sekuencat kohore – vendore. Jo pa qëllim përmendëm L. Spitzerin, në fillim të këtij punimi. Kjo sepse, për

metodën e Spitzerit është karakteristike kryerja e një lëvizjeje lart e poshtë, midis përshkrimit specifik të strukturave gjuhësore dhe interpretimit të domethënies së tekstit në tërësi. Madhështia, e veçuar si fjala e dytë çelës e poezisë, nënkupton të qenit madhështor, atë çka e bën madhështore figurën e këtyre vajzave. E gjithë kjo spikat në sfidën ndaj fatit të paracaktuar nga lart. Madhështia lidhet dhe krijon fushë semantike me fjalët, nxënës, hartim, gabime, shikim (fotoreporter) etj.

Përgjatë leximit të tekstit “mësueset...” të faniten si shtatore të gjalla (jo të pajeta, si ajo e Migjenit), por që vazhdojnë të madhështohen çdo ditë, çdo vit, falë thjeshtësisë, urtësisë, bukurisë, pse jo, edhe të pluhurit të shkumësit që u bie mbi supe dhe që i lartëson para lexuesit. Në fjalorin e shqipes fjala madhështi ka dy shpjegime:

1- Të qenit madhështor, vetia e të qenit madhështor,ajo që e bën madhështore diçka.

2- Të mbajturit me të madh, kryelartësi, mendjemadhësi.

Duket që leksema “madhështi” e përftuar nga teksti poetik nuk ka kurrfarë lidhjeje me kuptimet e mundshme të kësaj fjale në fjalor. Këtu është fjala për një madhështi të gjallë.

Këto janë prioritetet e tekstit poetik, aty organizohen fjalët në mënyrë të befasishme, vetjake, pa marrë parasysh normat e renditjes së fjalëve në një fjalor shpjegues.

Mësueset e fshatit qetësisht synojnë një jetë më të mirë e më të lirë, ato monumentalizohen para lexuesit i cili sheh tek to, jo më një qenie të dhimbshme, të viktimizuar, por një qenie madhështore që jeton çdo ditë me ta. Në raport me kë duhet të vlerësojmë punën e tyre?

Poezia është botuar në vitin 1976, kohë në të cilën diktatura i shtrëngoi deri në fund vidat e prangave që prangosnin lirinë. Poetë si Kadare tek të cilët liria e brendshme nuk u cenua, kishin dy mundësi, “ose të rrëzoheshin përgjithmonë, ose të ngriheshin përgjithmonë”⁵. “Lidhur me lirinë {...} nga që e kam njohur letërsinë, para lirisë ka qenë letërsia ajo që më ka çuar drejt lirisë dhe jo e kundërta”⁶.

“Mësueset e fshatit” është shembulli i gjallë i një antipeizazhi shpirtëror, shkruar në një kohë kur në kokën e shkrimtarit realiteti virtual përzihej me të njëmendtin. Kështu që lexuesi i sotëm më shumë duhet të nënkuptojë përmes hapësirave që krijon teksti se sa ta shohë ashiqare. Në sytë e nëpunësve shtetërorë ato (mësueset) duken të nëpërkëmbura, të

⁵ I. Kadare, *E vërteta që del nga qilarët*, vepra 20, f. 444.

⁶ *Po aty*, f. 445.

shpërfillura, të vogla, të pambrojtura. Krijohet një lidhjeje asociative antonimike me leksemën *pretendim*. Është e dukshme marrëdhënia kontrastuese që krijohet nga përdorimi në të dy rastet i leksemës “pretendim”.

Dhe janë pikërisht, ata, zyrtarët shtetërorë që vënë në dukje “pretendimet” e vajzave, pikërisht ata, “që bëjnë zhurmë”, “që kanë për vete 40 gojë”, ata që janë të aftë t’i shkruajnë letër organit më të lartë politik të shtetit shqiptar edhe “për një kuzhinë po t’u mungojë”.

Vini re përdorimin e leksemës “pretendime” në të dy rastet. Në rastin e parë përdoret për ato (mësueset) që presin (atje në rrugë /atje në shi) dhe zgjasin dorën për të kërkuar një vend në makinë, për t’i shpëtuar shiut e për të qenë një fundjavë pranë familjes. Në rastin e dytë leksema “pretendime” krijohet asociativisht nga zhurma e “zelltarëve” të shtetit që shkruajnë letër deri në Presidium, për kuzhinën e munguar.

Prezantimi në dy strofa i funksionarëve të shtetit, maksimalisht shpërfillës dhe burokratë të neveritshëm, vënë përballë figurës së mësueseve, është një tjetër gjetje që e madhështon figurën e tyre. Këtu është rasti të merret parasysh një prej argumenteve të Roman Ingarden: “...në nivelin e fjalëve përshkruese dhe të fjalive lihet hapësirë boshe, të cilën duhet ta mbushë lexuesi”. Këto “shtatore të gjalla” në raport me shpërfilljen shtetërore, të sjellin sërish në mendje Migjenin, “Merrnje dhe çonje në qytet këtë shtatore...”.

Nga tabloja migjeniane largohesh disi veçse kur ato i sheh në raport me nxënësit, me njerëzit e thjeshtë. Është krejt e pakuptueshme prirja e shefave të asaj kohe, për t’i çuar ato në zona më të thella dhe në çastin kur vulosnin emërimin një buzëqeshje cinike në fytyrën e shefave përthyhej në sintagmën “nxirje jete”.

“Mësueset e fshatit” është poezi asociative. Kadare aq sa evokon perceptime, aq edhe lë hapësira boshe për interpretime.

Në poezi dy leksemat që nënkuptohen përgjatë gjithë tekstit janë “liria” dhe “ëndrra”. Liria për to, në kuptimin parë që ka kjo fjalë është Gandiane. Mes vargjeshtë është më e dukshme liria për të ëndërruar se sa liria në konceptin e të qenit “i lirë”. Liria e ëndrrës përgjatë diskursit shenjohej “me shikimin e fotoreporterit” dhe vazhdon me kohën e fejesës e cila tashmë ka ardhur e po kalon.

Imazhi i ëndrrës së nusërisë, kryeëndrra e çdo vashe në moshë, shpaloset mes metaforës “pluhur i shkumësit, vello e bardhë” dhe pasohet nga sema “trondit” (në vargun “u bie mbi supe, i trondit”). Sema “trondit” dykuptimësohet brenda hapësirës tekstore dhe brenda kontekstit. Kuptimi i

parë lidhet me gjendjen e emocionit që krijon tek çdo vajzë ceremonia e aktit martesor, dhe kuptimi i dytë në raport me vargjet “Koha e fejesës i ka ardhur/ Dikujt ndoshta i shkon përditë...”, krijon një ndjesi dramatike. Koha që “shkon” e zhbën ëndrrën, e sublimon atë. Stilema “të urtat gjer në dhembje”, përsëritet edhe në vargun e fundit të poezisë. Kjo përmasë durimi, që rrezikon ëndrrën, të nesërmen e tyre, e madhështon figurën e vajzave:

“Po s’ngrenë ato botën
në këmbë
Në komitet, në ministri...”

Madhështia, siç duket qartë, krijon një fushë kuptimore edhe me fjalë të tilla si: komitet, ministri e botë. Duket krejt e pamundur të bësh një lidhje semantike të fjalës madhështi, me fjalët me konotacion zero/ negativ si ato që përmendëm më sipër. Kjo është përparësi e poezisë, e gjuhës së saj, i zotësisë se pazakontë të një autori që bën të pamundurën të kapshme e të besueshme. I tillë është Kadare, poeti që zotëron pushtetin e së pamundurës, ekzaktësisht siç konstaton Michel Foucault që “pushteti i së pamundurës përcillet në përvojën moderne nëpërmjet fjalësh të thëna... dhe se imagjinaria nuk ndërtohet duke mohuar a plotësuar realen..., ajo lind dhe formohet në hapësirat tekstore”⁷.

⁷ N. Pieagay – Gros, *Poetika e intertekstualitetit*, viti 2011, f. 183-184.